

JOYCE MEYER

TË MËSOJMË SI TË BESOJMË NË KOHËN E PERËNDISË



Kur,
o Zot,
Kur?

KUR, O ZOT, KUR?

KUR, O ZOT, KUR?

*Të mësojmë si të besojmë
në kohën e Perëndisë*

JOYCE
MEYER



JOYCE MEYER
MINISTRIES

KUR, O ZOT, KUR?

Joyce Meyer

Citimet biblike janë marrë nga Bibla, Versioni ABS. E drejta autorit © 2002 nga Albanian Bible Society. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përdorur me leje.

Në raste të tjera të përdorimit të citimeve biblike, informacioni jepet menjëherë pas përdorimit të tyre.

Botim i Joyce Meyer Ministries

© 2011 nga Joyce Meyer

P.O.Box 655

Fenton, Missouri 63026

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç rasteve të lejuara në ligjin mbi të drejtat e autorit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të shpërndahet, apo të transmetohet në asnjë formë apo mjet, apo të ruhet në një bazë të dhënash ose sistem rikthimi kompjuterik, pa pasur më parë miratimin e shkruar të publikuesit.

Përktheu: Florant Metko

Redaktoi: Sedika Fushekati

Shtypur në SIENA

Emri dhe logoja e Joyce Meyer Ministries janë shenja dalluese me të drejta ekskluzive të kësaj shërbese.

PËRMBAJTJA



<i>Parathënie</i>	7
1. Koha dhe Besimi	9
2. Stina e Përshtatshme	13
3. Koha e Caktuar	19
4. Thirrja	21
5. Vajosja	25
6. Veçimi	33
7. A jeni të Lodhur nga Pritja?	37
8. Durim, të Lutem!	43
9. Kur do të Plotësohet Ëndrra Ime?	47

PARATHËNIE



Ne i shërbejmë Perëndisë së Gjithëdijshtëm, i cili i mban sytë e Tij mbi ne gjatë gjithë kohës. Perëndia nuk çuditet kurrë. Ai di gjithçka *para* se të ndodhë. Te Psalmi 139 thuhet se Perëndia i njeh mendimet tona para se ne t'i mendojmë, madje edhe ato fjalë që nuk i kemi shqiptuar ende. Shumë prej nesh duhet të rritet në besim dhe të përpiqet të qëndrojë në heshtje ndaj pyetjes së madhe, KUR?

Duke qenë se kjo pyetje është ngulmuese, kam shkruar këtë libër për të sjellë disa mendime, për të cilat ndiej se Perëndia i ka ndarë me mua plot hir. Një pjesë të madhe të jetës sime e kam kaluar në padurim, mërzitje dhe zhgënjim. Përmes shumë përvojave kam kuptuar t'i besoj të Vetmit që i di të gjitha.

Lutem që fryma jote të ketë paqe, ndërsa prehet në Të, duke i besuar fjalëve të mbretit David kur thotë: “Në duart e tua unë e besoj frymën time” (Psa. 31:15).

1



KOHA DHE BESIMI

“Por unë kam besim te ti, o Zot; kam thënë: ‘Ti je Perëndia im’. Ditët e mia janë në dorën tënde; çliromë nga duart e armiqve të mi dhe të atyre që më përndjekin”.

Psalmi 31:14-15

*N*ë këtë kapitull psalmisti thotë se ai i jo vetëm i besoi Perëndisë për çlirim, por edhe se Ai do ta bënte në kohën e duhur. Besimi kërkon të themi: *“Ditët e mia janë në dorën tënde”*.

Kam mësuar se besimi kërkon të pranojmë se disa pyetje do të mbeten pa përgjigje dhe se kohën duhet ta lëmë në duart e Perëndisë, duke besuar se edhe pse nuk i dimë të gjitha përgjigjet, Ai tashmë i di. Ai ka kohën e Tij të duhur për të gjitha gjërat në jetët tona. Ne të gjithë besojmë dhe dëshirojmë që gjërat e mira të na ndodhin, TANI, *jo më vonë!*

Ndërsa piqemi vazhdimisht në jetën e krishterë, mësojmë të besojmë të presim për gjërat jo tani, por në kohën e duhur të Perëndisë. Te Hebrenjtë 11:1 thuhet: “Dhe besimi është siguria e gjërave që shpresohen, bindja e gjërave që nuk shihen”. Ne gjithmonë mund të kemi besim tani, por nuk mund të kemi gjithmonë manifestimin e tij *tani*.

T’i besosh Perëndisë shpesh kërkon të mos dish se si Ai do ta plotësojë atë që duhet bërë dhe as *kur* do ta bëjë atë. Ne gjithmonë themi: “Perëndia nuk është kurrë vonë,” por as se është herët. Përse? Sepse Ai i përdor ato mundësi për të shtrequr besimin tonë në Të dhe të rritemi gjatë kohës së pritjes.

Kohët e fundit, një nga partnerët tanë kishte nevojë për ndihmë financiare nga Perëndia për të paguar disa taksa të papritura. Taksat duhej të paguheshin deri në 15 prill. Çifti dha një ofertë të veçantë në Life in the Word (Jeta në Fjalë) duke i besuar Perëndisë për mrekullinë që kishin nevojë. Në datën 14 prill ata kishin paratë për të paguar taksat e tyre. Përse Zoti nuk i solli në datën 1 ose 5? Përse Perëndia ndonjëherë pret deri në ditën ose minutën e fundit?

Arsyeja është për të na mësuar mbi besimin! *Besimi nuk trashëgohet, ai mësohet!* Ne mësojmë t’i besojmë

Perëndisë duke kaluar nëpër përvoja të ndryshme, të cilat kërkojnë besim. Duke parë besnikërinë e Perëndisë, kohë pas kohe, ne fillojmë t'i besojmë më pak vetvetes dhe gradualisht hyjmë në çlodhjen e Perëndisë dhe vendosim besimin në Të.

Duke e parë në këtë mënyrë, është e lehtë të shikosh se si koha luan një rol të rëndësishëm për të mësuar t'i besojmë Perëndisë. Nëse Ai do të bëjë menjëherë çdo gjë që ne i kërkojmë, atëherë nuk do të rritemi dhe zhvillohemi kurrë. Koha dhe besimi janë binjakë. Ato punojnë krak për krah.

2



STINA E PËRSHTATSHME

*T*e Levitiku 26:4 thuhet: “Unë do t’ju jap shirat *sipas stinëve*.” Te Galatasve 6:9 thuhet se ne duhet “...të mos ligështohemi duke bërë të mirën; sepse, po të mos ligështohemi, do të korrim në kohën e vet”. Edhe te 1 Pjetrit 5:6 duhet të nxitemi të përulemi “nën dorën e pushtetshme të Perëndisë, që ai t’ju lartësojë në *kohën e duhur*”.

Kur është *stina e duhur* apo *koha e duhur*? Besoj se është kur Perëndia e di se jemi gati, kur kushdo tjetër i përfshirë është gati dhe kur përputhet me planin gjithpërfshirës të Perëndisë. Perëndia ka një plan specifik për jetët tona individuale, por gjithashtu ka një plan gjithpërfshirës për gjithë botën.

Më kujtohet se një herë u mërzita sepse nuk po ndodhte asgjë në shërbesën time. E dija se isha vajosur për t’u mësuar të tjerëve Fjalën e Perëndisë, por në

mënyrë absolute nuk po më hapej asnjë derë. Më dukej se kisha pritur shumë gjatë. Ndieja se isha gati. Unë kisha bashkëpunuar me Perëndinë. Ai do të bënte një punë të madhe në mua dhe thjesht nuk mundja ta kuptoja se përse nuk po ndodhte asgjë. Më kujtohet ndërsa pyesja: "Perëndi, çfarë po pret? Ende nuk jam gati?" Ai m'u përgjigj duke më thënë: "Ti je gati, por disa të tjerë që do të përfshihen me ty nuk janë ende gati dhe Unë po punoj me disa gjëra në ta, kështu që do të të duhet të presësh".

E shikon, Perëndia nuk i ngut, nuk i shtyn, nuk u kërkon, nuk i manipulon apo i detyron njerëzit. Ai udhëheq, udhëzon, nxit dhe sugjeron. Është përgjegjësia e secilit person për t'ia nënshtruar vullnetin Perëndisë për qëllimet e Tij. Nganjëherë kjo zgjat më shumë nga njëri person te tjetri.

Rrjedhimisht, nëse Perëndia po zhvillon një grup apo një ekip njerëzish që do të punojnë së bashku, një pjesë e tyre mund të jetë gati, ndërsa pjesa tjetër jo. Kjo është veçanërisht e vështirë në fazën fillestare, ku ata në përgjithësi nuk e dinë planin e Perëndisë dhe në të shumtën e rasteve madje nuk e njohin ende njëri-tjetrin.

Një shembull i goditur i kësaj që po flasim është kur një i ri ose e re lutet për shokun e përsosur të jetës.

Në fakt, Perëndia është duke e përgatitur atë, por njeriu që lutet lodhet së prituri pasi nuk e di se ç'po ndodh prapa kuintave. I riu ose e reja që lutet për një shok të jetës, që të jetë një i krishterë i pjekur, i rritur në frytin e Frymës dhe i thirrur në shërbesë me kohë të plotë etj., mund t'i duhet të presë "porosinë e veçantë" që t'i bëhet gati. Kjo kërkon kohë. Nuk ndodh brenda një nate. Megjithatë, Perëndia ka njeriun e duhur për ta.

Dave u martua shpejt me mua, por lutja e tij nuk ishte shumë kërkuese. Ai i kërkoi Perëndisë një bashkëshorte, të duhurën për të dhe që kishte nevojë për ndihmë. Ai u lut për gjashtë muaj me radhë, madje pothuajse një vit. U takuam dhe pas pesë takimesh u martuam. Tani që po botojmë këtë libër, më 1994, kemi njëzet e tetë vjet të martuar. Dave, gjithmonë ka thënë se e dinte se isha e duhura që natën e parë që dolëm, por ai priti dhe nuk më kërkoi të martoheshim sepse nuk donte të më frikësonte.

Ai, vetëm pas tre javë martese, arriti në përfundimin se unë kisha disa probleme dhe se më duhej ndihmë. Dave e mori shumë shpejt përgjigjen e lutjes së tij, por gjithashtu iu desh të duronte shumë kohë të vështira, ndërsa unë rritesha në Perëndinë dhe kapërceja problemet e së kaluarës sime abuzive.

Perëndia e dinte se Dave ishte aq i pjekur sa t'u bënte ballë viteve të ashpra me mua, prandaj iu përgjigj shpejt lutjes së tij. Ai ishte aq i fortë sa të ndihmonte dikë që kishte shumë probleme. Dave ishte i gatshëm të përdorej nga Perëndia në atë mënyrë dhe Perëndia e përdori atë. Nëse nuk do të kishte qenë në gjendje t'i bënte ballë apo nëse do të ishte lutur për dikë më të përsosur, atëherë besoj se Perëndia do ta kishte vonuar përgjigjen e Tij deri në një çast më të përshtatshëm, pasi të kishte ndryshuar disa gjëra në jetën time për të më bërë ashtu si Dave kërkonte.

Çfarë dua të them është se, kur presim në Perëndinë, është e rëndësishme të kuptojmë se Ai mund të jetë duke punuar tek njerëz të ndryshëm, me qëllim që t'i përgjigjet lutjes sonë. Duke e besuar këtë, pritja bëhet më e durueshme.

Le të mendojmë për *kohën e duhur* në lidhje me rritjen e financave. Tek 3 Gjoni, vargu 2 thuhet: "I dashur, uroj të kesh mbarësi në çdo gjë dhe të jesh shëndoshë, ashtu si ka mbarësi shpirti yt". Shprehja, *ashtu si ka mbarësi shpirti yt*, na tregon se mbarësia e Perëndisë varet nga pjekuria jonë. *Ashtu si ka mbarësi shpirti yt* i referohet mënyrës se si e lejojmë Perëndinë që të vendosë mendjen, vullnetin dhe emocionet tona në një linjë me

vullnetin e Tij.

Pjekuria është një proces që kërkon kohë. Koha varet nga plani i Perëndisë dhe nga bashkëpunimi ynë me të. Perëndia na do, prandaj nuk na jep më shumë mbarësi të cilën nuk jemi mjaftueshëm të pjekur për ta trajtuar siç duhet. Kështu, Ai na tregon te Galatasve 6:9 "Le të mos ligështohemi duke bërë të mirën; sepse, po të mos ligështohemi, do të korrim në kohën e vet." '*Koha e vet*' është koha kur Perëndia e di se jemi gati dhe jo kur *mendojmë* ne se jemi gati.

Bekimet e shumta, brenda një kohe të shkurtër, mund ta bëjnë njeriun kryelartë. Kështu, Bibla na udhëzon që të mos vendosim besimtarë të rinj në pozita drejtuese. Ata nuk janë të pjekur dhe kjo mund t'i bëjë të fryhen nga krenaria. (1 Tim. 3:6).

Ka një kohë për të gjitha gjërat në jetët tona dhe kur je në kohën e duhur të Perëndisë, ke *siguri*. Unë lutem të jem në vullnetin e duhur të Perëndisë dhe kohës së Tij, asnjë hap para dhe asnjë hap prapa.

3



KOHA E ÇAKTUAR

Jezusi u tha dishepujve te Veprat 1:6-8, kur e pyetën në lidhje me ditët e fundit, se nuk u takonte atyre të dinin se çfarë do të sillte koha dhe stinët, të cilat Ati i ka *caktuar* sipas zgjedhjes dhe fuqisë së Tij.

Siç e shikoni, dishepujt ende mendonin se Jezusi do të ngrinte një mbretëri tokësore. Ata e pyetën se kur do ta rivendoste mbretërinë në Izrael.

Dishepujt, nuk kishin arritur të kuptonin se Jezusi do të ngrinte një mbretëri frymërore dhe se mbretëria e Tij do të ishte brenda tyre. Bibla na paralajmëron se njohuria pa urtësi është e rrezikshme. Do të ishte shkatërruese për Jezusin t'u tregonte dishepujve se kur do ta themelonte mbretërinë, pepse ata nuk e kuptonin se çfarë ishte ajo.

Shpesh ne dëshirojmë të dimë *kur*, por Perëndia nuk mund të na e thotë sepse ne nuk kemi urtësi për t'i bërë

ballë kësaj njohurie. Te Habakuku 2:3 thuhet: “Sepse vegimi është për një kohë të caktuar, por në fund ai do të flasë [plotësohet] dhe nuk do të gënjejë; nëse vonon, prite, sepse me siguri do të vijë dhe nuk do të vonojë”. Perëndia nuk ka për t’u vonuar as edhe një ditë të vetme.

Koha e caktuar do të thotë se Perëndia e di kur është koha e duhur. Ne duhet të përulim veten dhe mendimet tona ndaj urtësisë dhe fuqisë së Perëndisë dhe t’i besojmë Atij kur thotë se nuk do të jetë vonë.

Koha e caktuar, gjithashtu, do të thotë një kohë tashmë e themeluar dhe e vendosur për arsye të caktuara. *Është njëlloj sikur kemi lënë një takim.* Nuk mund të nisemi nëse nuk ka ardhur koha. Kështu ndodh edhe me Perëndinë. Perëndia ka një kohë të caktuar, ose mund të themi se Ai na ka lënë takime në lidhje me çështje të caktuara të jetëve tona. Ne mund të ulemi dhe të presim me durim, sepse kjo do të ndodhë në kohën e duhur, dhe jo deri atëherë.

4



THIRRJA

Zakonisht, koha që një njeri thirret nga Perëndia për një punë të caktuar, vajolet dhe më pas veçohet për të vepruar, kalon në tre intervale të ndryshme. Shpesh, ekzistojnë hapësira të gjata kohe mes këtyre tre intervaleve, veçanërisht nëse ky njeri do të përdoret nga Perëndia në mënyrë të rëndësishme. *E rëndësishme* nuk do të thotë domosdoshmërisht mbarë-botërore. Thjesht do të thotë një mënyrë që do të ndikojë një numër të konsiderueshëm njerëzish. Në këtë kapitull dhe në dy kapitujt e tjerë pasardhës, do të shikojmë secilën nga këto ngjarje veçmas.

Kur Perëndia vendos një thirrje në jetën e dikujt, ajo mund të vijë papritur, ose mund të jetë diçka që, në një farë mënyre, personi mund ta ketë ditur gjithmonë. Kam lexuar se një nga presidentët e Amerikës, ishte shprehur në një intervistë se, që kur kishte qenë i ri,

gjithmonë kishte pasur dëshirë dhe "thjesht e dinte" se një ditë do të bëhej president i Shteteve të Bashkuara.

Unë e kam marrë thirrjen në mënyrë shumë të papritur. Një mëngjes po rregulloja krevatin dhe zëri i Zotit më tha: "Ti do të shkosh kudo dhe do të shpjegosh Fjalën Time dhe do të kesh një shërbesë të madhe me mësim të rregjistruara në audio-kaseta ". Edhe pse nuk ishte një zë i dëgjueshëm për veshët, mua më tingëlloi shumë i lartë dhe i qartë nga përbrenda. Që nga ai moment e në vazhdim, unë "thjesht e dija" se ai ishte fati im dhe kisha një dëshirë të madhe, shpesh dërrmuese, për të mësuar Fjalën e Perëndisë.

Para asaj dite, nuk e dija se isha thirrur të predikoja e të mësoja Fjalën e Perëndisë. Megjithatë, tani mund vështroj prapa dhe të shikoj tabela të tjera drejtuese përgjatë rrugës së jetës sime. Gjithmonë kam pasur aftësi të shprehem verbalisht dhe me shkrim në mënyrë shumë të qartë dhe të kuptueshme. Madje, kur isha në shkollë të mesme, shumë njerëz vinin e më kërkonin ndihmë dhe këshilla për problemet e tyre. Që atëherë kisha dëshirë t'i ndihmoja të tjerët në drejtimin e jetës së tyre. Madje, më kërkonin t'u jepja adresën e ceremonisë së diplomimit, për t'i motivuar dhe nxitur bashkëmoshtarët e klasës drejt gjërave më të mëdha. Në atë kohë,

ëndërroja të diplomohesha në psikologji me qëllim që t'i ndihmoja njerëzit, si profesioniste.

Pasi unë dhe Dave u martuam disa vite më vonë, unë po rritesha më shumë në Zotin, por akoma luftoja me probleme të mëdha për shkak të së kaluarës sime abuzive. Në këtë kohë ne kishim tre fëmijë. Më kujtohet kur kthehesha në shtëpi, nga kisha, dhe shtrihesha në krevat të dielave në darkë pasi fëmijët i kishte zënë gjumi. Shtëpia ishte plot paqe, e qetë dhe e errët dhe aty unë mund të ripredikojë edhe një herë predikimin e pastorit. Atëherë kurrë nuk e mendoja përse e bëja këtë, por tani e di.

Thirrja juaj mund të vijë gradualisht ose papritur, por nga koha kur je thirrur, *ti je në proces përgatitjeje*.

5



VAJOSJA

Gjatë kohës së përgatitjes, vajosja vjen në kohën e duhur. Vajosja është aftësimi që na jep Fryma e Shenjtë për të bërë atë që Perëndia na ka thirrur të bëjmë. Fryma e Shenjtë na mëson, ndreq, shenjtëron, ndihmon dhe na forcon. Ai na formon dhe na kthen në enë të përshtatshme për t'u përdour nga Mjeshtri. Ky proces mund të kërkojë shumë vite.

Mendoni pak për Moisiun. Ai ndjeu thirrjen për të çliruar njerëzit e tij nga skllavëria. Ai vrau egjiptasin që po keq-trajtonte një izraelit dhe për pasojë kaloi dyzet vjet në anën tjetër të shkretëtirës duke mësuar të kulloste delet, të njihte Perëndinë dhe të ishte i përulur. *Ai po përfitonte përvojë.* Një person pa trajnim, pa përvojë dhe pa përulësi nuk mund ta dallojë ndryshimin midis zellit dhe kohës së Perëndisë.

Vajosja vjen në bazë të bashkëpunimit tonë në procesin e përgatitjes. Kujtoni Jozefin, i thirrur nga Perëndia për të qeverisur në Egjipt dhe për të shpëtuar njerëzit nga uria. Ai shihte ëndrra për këtë gjë që kur ishte një djalë i ri. Në zell e sipër, ua tregoi ëndrrat vëllezërve të tij. Ata nuk u gëzuan nga mendimi se do t'i përulëshin vëllait të tyre të vogël, kështu që e shitën.

Jozefi nuk donte të bënte ndonjë gjë të keqe. Ai ishte djalë i ëmbël, por nuk tregoi urtësi që i tregoi ëndrrat e tij. Jozefi kaloi disa vite të vështira, por ato vite e stërvitën atë në urtësi. Përvojat, në të cilat Perëndia e kaloi, e përgatitën për thirrjen e jetës së tij. Jozefi përjetoi tradhti jo vetëm nga familja, por edhe nga miqtë, që i kishte trajtuar mirë dhe të cilëve mendonte se mund t'u besonte. Ai u gënjye, u keqgjykua dhe u dënua për gjëra që nuk i kishte bërë. U desh të kalonin shumë vite para se Jozefi të shikonte përmbushjen e ëndrrave të tij.

Të gjithë kemi përvoja të tilla të ngjashme që na ndihmojnë të rritemi. Ato na përgatisin për t'i shërbyer Perëndisë dhe për të qëndruar të patundur, pavarësisht rrethanave. Nuk është Perëndia që na sjell shqetësime, por Satani. Djalli mendon vetëm për shkatërrimin tonë, por Perëndia e kthen në të kundërt dhe e përdor atë për të mirën tonë. Jozefi e dinte këtë gjë sepse te Zanafilla

50:20 ai u tha vëllezërve të penduar: “Ju keni kurdisur të këqija kundër meje, por Perëndia ka dashur që t’i shërbejë së mirës”.

Kur Perëndia më thirri të jepja mësim mbi Fjalën e Tij, familja dhe miqtë e mi më kundërshtuan. Kjo gjë më lëndoi dhe më bëri të ndihesha e vetmuar. Ndihesha e keqgjykuar, e keqkuptuar dhe e përfolur jo në mënyrë të duhur. Por, edhe unë isha e nxituar, e rrëmbyer, plot zell, por pa urtësi. Me pak fjalë, *mendjen e kisha tek vetja*. Gjithashtu, mund të shtoj se, gjithsecili mendon vetëm për vete derisa të kalojë nëpër procesin e përgatitjes.

Nëse ju ndodh të mendoni: “Jo, unë nuk i kam këto probleme”, atëherë më lejoni t’ju sugjeroj se jeni gati për një rizgjim të fortë në jetën tuaj! Derisa të përuleni “nën dorën e pushtetshme të Perëndisë”, koha juaj e duhur nuk ka për të ardhur kurrë. (1 Pjetri 5:6).

Nëse vështroj prapa, mund të shikoj faza të dallueshme të progresit në shërbesën time që lidhen me fazat e rritjes personale dhe të një vajosjeje më të madhe.

Studime Biblike në Shtëpi

Një nga hapat e para, që Perëndia më udhëzoi të bëja, ishte të ndërprisja punën me kohë të plotë, për t’u

përgatitur për shërbesë. Ky vendim i preu të ardhurat tona në gjysmë. Perëndia gjithmonë i plotësoi nevojat tona, por ato vite ishin të vështira.

Fillova të zhvilloja studime biblike në shtëpi të cilat zgjatën për pothuajse pesë vjet. Gjatë dy viteve e gjysmë të para, jepja mësim njëherë në javë. Takimi u rrit kaq shumë sa fillova të zhvilloja dy takime, një në mëngjes dhe tjetrin në mbrëmje. Edhe pse po përjetonim stres të paparë financiar në atë kohë, unë nuk përfitoja asgjë nga ato takime.

Pjesëmarrësit, rreth njëzet e pesë në secilin takim, e kundërshtuan idenë e mbledhjes së ofertës për ne, edhe pse ishte e dukshme që ne ishim në nevojë. Ishte shumë e vështirë për mua, por kjo pastroi motivet e mia për të dhënë mësim. Vazhdova të jepja mësim, kështu që nuk po e bëja këtë gjë për para. Ndonëse me raste ishte e vështirë të mos mërzhitesha në sy të njerëzve, unë aty mësova se gjërat po ndodhnin në atë mënyrë, sepse Perëndia nuk donte që unë ta dija se nga do të më vinte mbështetja. Ai dëshironte të ishte burimi im dhe kjo kërkon *kohë* si edhe përballimin e situatave të vështira nga të cilat duam të largohemi.

Shumë largohen vërtet. Ata janë thirrur, por duke qenë se nuk janë të gatshëm të durojnë kohën

përgatitore, nuk zgjidhen kurrë. Mateu 20:16 thotë: "... shumë janë të thirrur por pak janë të zgjedhur". Dikur kam dëgjuar një folës i cili e interpretoi: "Shumë janë thirrur, por pak janë të gatshëm të pranojnë përgjegjësinë për thirrjen".

Përkthimi nga *Amplified Bible* për 2 Timoteut 2:15 shpjegon pak mbi përgjegjësitë që kemi për thirrjen: "Ji i zellshëm të dalësh para Perëndisë si i sprovuar (i testuar nga provat), si punëtor që nuk ka pse të turpërohet, që ndan (mban drejt dhe mëson plot talent) drejt fjalën e së vërtetës".

Gjatë atyre viteve mësimdhënjeje në dhomën e ndenjjes, para njëzet e pesë njerëzish, Perëndia më mësoi shumë rreth shërbesës.

Vendos në raft

Më pas, kalova një vit të tërë duke mos bërë absolutisht asgjë në shërbesë. Perëndia më tha: "Ndaloji studimet biblike në shtëpi. Ja, unë po të jap diçka të re!". Dëshira për të zhvilluar studimet biblike në shtëpi tashmë ishte venitur! Tashmë unë kisha një foshnjë dhe çdo gjë në zemrën time, si edhe rrethanat, më dhanë besim tek ajo Fjalë e Perëndisë.

Në një farë mënyre ishte e vështirë të bindesha. Më në fund, njerëzit kishin filluar të na jepnin një ofertë të vogël, pesëmbëdhjetë deri pesëdhjetë dollarë çdo javë. Tani, më duhej të isha e gatshme të hiqja dorë nga kjo shumë parash, me qëllim që të hidhja hapin tjetër.

Mishi im priste të ndodhte ndonjë gjë e madhe pas bindjes sime sakrifikuese, e megjithatë, *për një vit të tërë nuk ndodhi asgjë!* Asnjë derë e hapur. Ky ishte një nga vitet më të vështira të jetës time. A mos e kisha humbur Perëndinë? A mos e kisha sajuar unë gjithë atë vizion? A do të ndodhte ndonjë herë? Çfarë mund të bëja që kjo të ndodhte? Perëndia vazhdonte të më thoshte: “Ndalu dhe prano që jam Perëndi” (Psa. 46:10).

Nganjëherë është kaq e vështirë të qëndrosh në pritje për kohën e Perëndisë. Asokohe nuk e kuptoja atë që po ju them tani. Ne i kuptojmë gjërat më qartë kur i shikojmë mbrapa dhe akoma më pak ndërsa kalojmë nëpër to. Nganjëherë Perëndia i vendos njerëzit në raft dhe i lë të ulen aty. Ndonëse duket se nuk po ndodh asgjë, shumë gjëra përmbushen në Frymë. Kjo është një kohë rritjeje, akordimi, pastrimi dhe besimi, kohë e cila duket sikur nuk ka asgjë për të parë.

Pesë vitet e tjera

Në fund të këtij viti në pritje, Dave dhe unë filluam të shkonim në një kishë tjetër që sapo kishte filluar në zonën e St. Louis. Ajo ishte e vogël, me rreth tridhjetë njerëz, por ne kishim një dëshmi shumë të fuqishme në zemër se Perëndia dëshironte të ishim aty. Pas pak kohësh, m'u dha mundësia të nisja një Takim Grash të enjteve në mëngjes, në kishë, Qendra e Jetës së Krishterë. Ky takim ishte faza tjetër e shërbesës sime dhe *ishte në kohën e Perëndisë*.

Ndërsa Ai e bekonte, kjo shërbesë rritej dhe në kulmin e saj kishte një pjesëmarrje prej katërqind grash çdo javë. Kështu nisa të punoja me kohë të plotë në kishë dhe u bëra ndihmës-pastor. U fuqizova shumë nëpërmjet Qendrës së Jetës së Krishterë dhe aty jepja mësim mbi Biblën. Më vonë, kisha sponsorizoi programin tim të parë radiofonik i cili nisi të transmetohej në St. Louis.

Mësova shumë gjatë pesë viteve të mia aty. Një nga gjërat që mësova ishte si t'i nënshtrohesha autoritetit. Një njeri nuk është i përshtatshëm për të qenë autoritet nëse nuk ka përjetuar ardhjen nën autoritet. Mos harroni,

nënshtrimi nuk është thjesht veprim, është qëndrim. Ju mund të vendosni të bëni atë që ju është thënë, por qëndrimi përulës duhet të lindë në ju, veçanërisht nëse jeni me vullnet të hekurt si unë.

Gjatë kësaj kohe mësova të punoj në grup dhe të shërbeja në lloje të ndryshme shërbesash. Gjithashtu mësova akoma më shumë rreth pritjes. Perëndia kishte vendosur shumë gjëra në zemrën time, gjëra që unë doja të bëja, por edhe një herë, nuk ishte koha e duhur, pra akoma më shumë pritje, më shumë mësim dhe rritje.

Këto ishin vite të mëdha dhe vështira, të mbushura me qeshje dhe lot, gëzim dhe zhgënjim. Përmes gjithë kësaj, pastorët e Qendrës së Jetës së Krishterë, Rick dhe Donna Shelton, Dave dhe unë, u bëmë dhe jemi akoma miq të ngushtë. Të gjithë u rritëm së bashku.

Kam mësuar se kur njerëzit rriten së bashku, nëse nuk heqin dorë nga njëri-tjetri, ata zakonisht ndërthuren në një marrëdhënie të thellë që zgjat përgjithnjë. Pra mund të thoni se ndërsa kleçkat shturen dhe largohen nga ju, atëherë ju ndërthureni me njëri-tjetrin.

Kur Qendra e Jetës së Krishterë u rrit në një bashkësi me rreth 1200 njerëz, ekipi po përgatitej të shpërngulej në një ndërtesë të re dhe të bukur. Çdo gjë po shpërthente me fitore dhe gëzim, kur, Perëndia foli sërish.

6



VEÇIMI

Fillon Jeta në Fjalë

A ju kujtohet kur Perëndia më foli në fillim? “Thirrja” erdhi ndërsa po rregulloja krevatin dhe Zoti më tha: “Ti do të shkosh kudo ... dhe do të kesh një shërbesë të madhe me mësim të regjistruara në audio-kaseta.” Kjo ishte përmbushur shumë pak gjatë viteve të përgatitjes, por vizioni ishte rritur në zona të tjera.

Një ditë, ndërsa lutesha, më erdhi fuqishëm një një varg i veçantë nga Shkrimet, Filipianëve 2:15. Aty thuhej: “*ndriço si pishtar në botë, duke e mbajtur lart fjalën e jetës.*” Atë ditë unë mora vizionin për të mbuluar gjithë kombin me anë të radios.

Në kohën kur më erdhi ky vizion, nuk punoja në ndonjë stacion radiofonik. Kisha udhëtuar disi, por jo shumë larg. Në zemrën time kishte akoma më shumë.

Vazhdoja të mendoja se Perëndia, në një farë mënyre, do ta përmbushte këtë vizion në punën time në Qendrën e Jetës së Krishterë, të cilën unë e pëlqeja shumë. Por Perëndia kishte plane të tjera.

Te Fjalët e Urta 16:9 thuhet: "Zemra e njeriut llogarit rrugën e tij, por Zoti drejton hapat e tij". Unë e kisha një plan. Mendoja se ky ishte plani i Perëndisë, por Ai foli sërish dhe më tha: "Këtu mbarova me ty. Merr shërbesën dhe shko në Veri, Jug, Lindje dhe Perëndim." Pashë në frymë se duhej të nisja në vende të tjera të njëjtat takime "Jetë në Fjalë" që zhvilloheshin në Qendrën e Jetës së Krishterë. Luftova me këtë çështje për një kohë të gjatë, por më në fund ndjeva sigurinë se ishte Perëndia ai që do të vepronte. Gjithashtu e dija se, nëse e kisha gabim, atëherë do të humbisja gjithçka që ato dhjetë vite përfaqësonin. Isha e frikësuar!

Më në fund iu binda Perëndisë dhe e lashë punën në kishë. Pikërisht gjatë këtij tranzicioni Perëndia më tregoi se po më veçonte për "thirrjen" e jetës sime. Çdo gjë tjetër kishte qenë e mrekullueshme, por e gjitha ishte parapërgatitje. Vajosja e Perëndisë rritej në çdo hap të rrugës dhe njëkohësisht rriteshin edhe përgjegjësitë e mia.

Te Veprat 13:2 thuhet se ndërsa shenjtorët "po kryenin shërbesën e Zotit", Fryma e Shenjtë u tha të

ndanin Palin dhe Barnabën për veprën për të cilën i kishte thirrur. Ata po bënin vepra në shërbesë, gjëra të frytshme që sillnin bekime. Por në kohën e Perëndisë, Ai tha: “Tani është koha e duhur”.

Dua t’ju inkurajoj se, në kohën e Perëndisë, do të shikoni të plotësohen ëndrrat dhe vizionet që Ai ju ka dhënë. Nëse ka vendosur një thirrje të caktuar në jetën tuaj, Ai do ta plotësojë atë në kohën e Tij. Bashkëveproni në secilin hap të rrugës tuaj dhe mos harroni se thirrja, vajosja dhe veçimi për thirrje mund të ndodhin në një periudhë të gjatë vitesh. *Ji besnik në të gjitha gjërat e vogla. Koha jote është në duart e Tij.*

7



A JENI TË LODHUR NGA PRITJA?

Nëse prisni për një kohë të gjatë dhe nuk keni parë ndonjë përmirësim, ndoshta po lodheni shumë nga pritja. Dëshiroj t'ju inkurajoj të merrni një qëndrim të freskët ndaj pritjes. Bibla, te Marku 4:20-27, thotë se duhet të jemi të duruar si mbjellësi që vendos farën nën tokë dhe pastaj pret shiun e hershëm ose të vonë. Vargu vazhdon më tej duke thënë se ndërsa pret që fara të mbijë, ai shkon dhe bie në shtrat, dhe si përfundim fara mbin. Dhe ai, fermeri, nuk e di se si.

Nëpërmjet këtyre vargjeve, Perëndia më ka treguar se unë duhet të vazhdoj ta jetoj jetën, ndërsa pres të ndodhin që gjërat që kam për zemër. Ne mund të fiksohemi aq shumë në realizimin e gjërave të së ardhmes, sa që nuk kujdesemi dhe nuk i gëzojmë gjërat e së tashmes.

Unë e mora vizionin nga Perëndia dhjetë vjet para se të filloja ta shikoja atë të plotësuar. Gjatë këtyre dhjetë viteve, besoj se kam humbur shumë gëzim duke u përpjekur për të vepruar jashtë kohës së Perëndisë.

Le të themi se një grua që ka pesë fëmijë mbetet shtatzënë. Do të ishte shumë qesharake nëse ajo do ta lindte fëmijën që në muajin e parë. Po nëse ajo do të përpiqej aq shumë të lindte fëmijën, sa të linte pas dore kujdesin pesë të tjerëve? Ne mund ta shikojmë qartë marrëzinë e këtij skenari. Megjithatë, në të vërtetë, njerëzit shpesh bëjnë të njëjtën gjë në situata të tjera.

Gëzoni vendin ku jeni ndërsa prisni të shkoni atje ku dëshironi të jeni! Kur Bibla thotë se fermeri binte në shtrat dhe ngrihej sërish, besoj se nënkupton se ai e jetonte jetën e përditshme ndërsa priste që kopshti, që kishte në mendje, të lulëzonte.

Një ditë, pastori erdhi të na priste në një aeroport të mbipopulluar. Aty kishte shumë njerëz. Tek shkallët lëvizëse kishte radhë, edhe restorantet kishin radhë. Dukej se kudo që ktheheshim, na duhej të prisnim. Po kuptoja se pastori po mërzohej me këtë situatë. Papritur, ai u kthye nga unë dhe më tha: “Besoj se e shikon se nuk jam i mirë për të pritur”.

Nëse nuk kemi mësuar të presim, rezultatet janë të dukshme jo vetëm në mënyrën emocionale të sjelljes, por edhe në trupat tanë fizik. Pritja është një pjesë e jetës dhe nëse ajo sjell gjithmonë mërzitje, atëherë krijon stres që pastaj lë gjurmë në trupin tonë fizik dhe mund të shkaktojë sëmundje. Ky pastor që nuk ishte i mirë në “pritje” ishte shumë i sëmurë dhe kishte dobësi fizike, të cilën doktori i kishte thënë se i kishte ardhur nga vitet e stresit. *Mbani një qëndrim të ri ndaj pritjes dhe nuk do të jetë kaq e vështirë për ju.*

Në të vërtetë, ne kalojmë më shumë kohë në jetën tonë duke pritur sesa duke marrë. Pasi marrim atë për të cilën jemi duke pritur, do të fillojmë të presim për diçka tjetër. Nëse e kuptoni ç’ka dua të them, do të jeni në gjendje ta kuptoni shpejt se *pritja është pjesë kryesore e jetës.*

Le të themi se morët rritje rroge dhe pastaj prisni për një tjetër. Ju prisni për fëmijë, pastaj prisni që të heqin pelenat dhe të veshin të mbathura, dhe pastaj prisni që shumë shpejt ata të jenë në gjendje t’i blejnë vetë pantallonat e tyre! Ju prisni për të blerë një shtëpi, pastaj prisni të blini mobiliet për shtëpinë për të cilën nuk po prisni më. Pastaj prisni të jeni në gjendje të përballoni të paguani një grua që t’ju ndihmojë të

pastroni shtëpinë dhe mobiljet për të cilat ishit duke pritur. A e kuptoni se çfarë dua t'ju them?

Qëndroni të gëzuar ndërsa prisni. Mundohuni të kuptoni se pritja është ajo që do të çlirojë ëndrrën tuaj. Në të vërtetë duhet të them se "pritja e mirë" është ajo që do të çlirojë ëndrrën tuaj. Sigurisht, plotësimi vjen nga Perëndia, por pritja i ngjason ardhjes së postierit. Ndonjëherë ne nisim të presim për postierin. Kur ai më në fund vjen, ne kemi ikur dhe kemi nisur të bëjmë diçka tjetër dhe ndoshta nuk do të jemi as në përfundimin e punës së fundit.

Shpesh, njerëzit e paduruar nuk presin dot mjaftueshëm për të parë përfundimin e gjërave vërtet të mëdha, sepse gjërat e mëdha kërkojnë shumë kohë për t'u pjekur. Bashkëshorti im, Dave, gjithmonë thotë: *"Shpejt dhe brishtë; ngadalë dhe solid."* Nëse një gjë bëhet shpejt e shpejt, për të kënaqur njerëzit e paduruar dhe ata që nuk dinë të presin, ka shumë gjasa që ajo të mos zgjasë. Por, nëse njerëzit janë të gatshëm të presin kohën e duhur të Perëndisë, atëherë ajo do të jetë e drejtë dhe do të zgjasë për një kohë të gjatë.

Ka raste, që në shërbesë shikojmë "meteorë". Këta janë njerëz që duket sikur vijnë nga askundi dhe brenda natës bëhen të njohur në mbarë botën, sepse shfaqen

me një grup të caktuar njerëzish që kanë aftësinë të hapin dyert. Shërbesat e tyre rrallë zgjasin për një kohë të gjatë. Shpesh, këta njerëz futen në telashe financiare ose morale, sepse karakteri ndërtohet gjatë kohëve të vështira të pritjes, por ata nuk kanë kaluar përmes asaj kohe të ndërtimit të karakterit.

Nëse një njeri, në njëfarë mënyre i shmang të gjitha situatat e vështira dhe shkëlqen brenda një nate, zakonisht nuk e ka të gjatë. Tek Marku 4:5-6 thuhet se fara që mbin brenda natës, thahet kur bie vapa. Kur ne të mësojmë përfundimisht të respektojmë dhe kënaqemi në kohët e pritjes, atëherë Perëndia do të veprojë menjëherë. Dhe edhe pse nuk mund të shikojmë se ç'po ndodh, gjërat që më vonë do të na bëjnë të lumtur, po ndodhin pikërisht tani, prapa kuintave.

8



DURIM, TË LUTEM!

Bibla thotë te Letra e Hebrenjve 6:12 se ne i trashëgojmë premtimet nëpërmjet besimit dhe durimit. Trashëgimia nuk kërkon ndonjë përpjekje, por vetëm pritje deri në kohën e caktuar. Për shembull, ju mund të mendoni ose të besoni se një i afërm është i gatshëm t'ju lërë trashëgiminë, por duhet të duroni dhe të prisni kohën e duhur për ta marrë atë. Besimi dhe durimi janë partnerë. Ata veprojnë së bashku për të sjellë rezultatin e dëshiruar.

Tek Jakobi 1:2-3 thuhet se duhet të gëzohemi kur kalojmë “tundime të ndryshme” duke ditur se “sprova e besimit sjell durim”. Dhe kur durimi të ketë bërë punën e vet, ne do të jemi “të përsosur dhe të plotë, pa asnjë mangësi”. Uau! Çfarë vargu!

Në këtë varg, fjala greke “durim”, nënkupton atë lloj “durimi që rritet vetëm në sprova.”¹ Me fjalë të tjera, si mund të rritemi në durim nëse nuk na kërkohet të presim për atë çka dëshirojmë ose të durojmë diçka që nuk e dëshirojmë?

Kur kemi sprova, ne rritemi, ose le të themi se mund të rritemi nëse lejojmë që durimi “të kryejë ... një vepër të përsosur” (Jakobi 1:4). Kundërshtimi, hidhërimi dhe largimi nga vështirësitë nuk prodhon durim. Jakobi 1:4 thotë se ne mund të zhvillohemi përsosmërisht, pa asnjë mangësi (ose “pa dëshiruar asgjë më tepër”) kur durimi të ketë bërë një vepër të përsosur. Kjo gjë mund të shihet lehtë. Nëse një njeri është totalisht i duruar, ai/ajo mund të ketë paqe dhe gëzim në çdo situatë.

Sigurisht, unë nuk jam e përsosur në durim, por jam rritur shumë. Ka qenë një kohë kur isha tmerrësisht e paduruar dhe nuk dija të prisja. Më në fund kuptova se Perëndia nuk do të ndryshonte, kështu vendosa se ishte më mirë që unë të ndryshoja dhe t’i përshtatesha rrugëve të Tij. Ai thotë se ne marrim nëpërmjet besimit dhe durimit, kështu vendosa të zhvilloj durimin. *Unë*

¹ W. E. Vine, *An Expository Dictionary of New Testament Words* (Old Tappan, New Jersey: Fleming H. Revell Co., 1940), Vol. III, p. 167.

jam rritur në durim, dhe në të njëjtën masë, kam marrë paqe dhe gëzim.

Durimi është fryt i Frymës. Durimi është dëshmi e fuqishme për jobesimtarët. Ai i ngjason muskulit, sa më shumë ta përdorësh, aq më i fortë bëhet. Pastaj, në përfundim, ai zhvillohet plotësisht dhe juve ju mbetet të bëni ushtrime për ta mbajtur veten në formë në fushën e durimit—ndaj gjërave të ndryshme që nuk ndodhin sipas planit, si njerëz të ngadaltë, makina e fikur në autostradë, kur nuk kuptoni se çfarë po ndodh në jetën tuaj apo nevoja për përgjigje, të cilat duken sikur vijnë shumë ngadalë.

Të gjitha këto gjëra na ndihmojnë, edhe pse kur kalojmë nëpër to, ndjejmë vështirësi. Nëse arrijmë ta kuptojmë këtë, atëherë do ta vlerësojmë sërish durimin. Hebrenjve 12:1 na inkurajon të themi: “Prandaj edhe ne, duke qenë të rrethuar nga një re kaq e madhe dëshmitarësh, duke hedhur tej çdo barrë dhe mëkatin që na qarkon kaq lehtë, le të rendim me durim në garën që është para nesh”. Çdo garë ka një përfundim. Ju do ta kaloni vijën e përfundimit, por Hebrenjtë na tregojnë se si të vrapojmë në garë.

Jini të Duruar me Vetën Tuaj.

Më lejoni t'ju inkurajoj të themeloni një jetë me durim, duke filluar së pari të jeni të duruar me veten tuaj. Kur gaboni, merrni mëshirë nga Perëndia dhe vazhdoni drejt vijës së përfundimit. Jini të duruar me veten, ndërsa përpiqeni të mposhtni dobësitë tuaja. *Padurimi ushqen mërzitjen.* Mërzitja na çon drejt një gjendjeje të paqëndrueshme emocionale, saqë përfundojmë duke gabuar më shumë sesa po të kishim treguar që në fillim, pak më shumë durim.

Njerëzit përmirësohen më shpejt nën durim sesa nën presion! Jini bujarë me durimin. Jepjani atë lehtësisht vetes dhe të tjerëve. Përfitimet kanë për të qenë të kënaqshme! Luka 8:15 thotë se njerëzit "japin fryt me durim."

9



KUR DO TË PLOTËSOHET ËNDRRA IME?

Ëndrra juaj po ndodh pikërisht tani! Ajo është në sobë dhe po piqet. Një shprehje thotë: “Po t’ia ngulësh sytë enës, ajo nuk zien”. Ju inkurajoj që thjesht të merrni më të mirën e çdo dite. Bëni pjesën tuaj, por mos u përpiqni të bëni pjesën e Perëndisë.

Ka një kohë të përsosur—koha e Perëndisë! Vetëm Ai e di se kur. Nderojeni Perëndinë duke i besuar Atij dhe ndërsa udhëtoni në rrugën e përmbushjes, *shijoni udhëtimin!*

Askush nuk mund t’ju thotë me saktësi se kur do të vijë, por jini të sigurt se do të vijë në kohën e duhur.

Besojeni dhe hyni në prehjen e Perëndisë!

TË PËRJETOSH NJË JETË TË RE



Nëse nuk e keni ftuar kurrë Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin tuaj, atëherë ju ftoj ta bëni këtë gjë tani. Ju mund të thoni këtë lutje dhe nëse do të jeni vërtet të sinqertë, do të përjetoni një jetë të re në Krishtin.

At Perëndi, unë besoj se Jezu Krishti është Biri Yt, Shpëtimtari i botës. Unë besoj se Ai vdiq në kryq për mua dhe mori të gjitha mëkatet e mia. Ai shkoi në ferr në vendin tim dhe triumfoi mbi vdekjen dhe varrin. Unë besoj se Jezusi u ringjall nga të vdekurit dhe tani qëndron i ulur në të djathtën tënde. Kam nevojë për Ty, Jezus. Fali mëkatet e mia, më shpëto, eja dhe jeto brenda meje. Unë dua të lind sërish.

Tani, besoni se Jezusi jeton në zemrën tuaj. Ju jeni falur dhe jeni shpallur të drejtë dhe kur Jezusi të vijë, ju do të shkoni në parajsë.

Gjeni një kishë të mirë që mëson Fjalën e Perëndisë dhe filloni të rriteni në Krishtin. Asgjë nuk do të ndryshojë në jetën tuaj nëse nuk njihni Fjalën e Perëndisë.

Të dashur,

Gjoni 8:31-32 thotë: "Nëse do të qëndroni në fjalën time, jeni me të vërtetë dishepujt e mi; do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t'ju bëjë të lirë."

Ju nxis të qëndroni në Fjalën e Perëndisë, ta mbillni atë thellë në zemër dhe sipas 2 Korintasve 3:18, ndërsa shikoni drejt Fjalës, ju do të shndërroheni në shëmbëllimin e Jezu Krishtit.

Më shkruani dhe më thoni nëse e keni pranuar Jezusin dhe kërkon për një libër të vogël falas mbi fillimin e jetës së re në Krishtin.

Me dashuri,

Joyce

DY FJALË RRETH AUTORES

JOYCE MEYER është një nga mësueset kryesore praktike të Biblës në botë. Si autorja Nr.1 më e shitur e gazetës *New York Times* ajo ka shkruar më shumë se tetëdhjetë libra frymëzues, përfshirë këtu *Kurrë mos u dorëzo*, *Sekreti i kënaqësisë së vërtetë*, *100 mënyra për të thjeshtëzuar jetën tënde*, gjithë grupin e librave *Fushëbeteja e Mendjes*, si dhe nismën e saj në gjininë e romanit me titullin *Qindarka dhe Çdo Minutë*, dhe shumë të tjerë. Ajo gjithashtu ka transmetuar mijëra mësim audio, dhe ka tashmë një bibliotekë të plotë në video. Programet radio-televizive të Joyce Meyer, *Të shijosh jetën e përditshme*® transmetohen në mbarë botën, ndërkohë që ajo udhëton shumë për të mbajtur konfe-renca. Mesazhet e saj, ju mund t'i ndiqni në disa gjuhë të ndryshme në tv.joycemeyer.org. Joyce dhe bashkëshorti i saj, Dave, janë prindërit e katër fëmijëve të rritur dhe banojnë në St. Louis, Missouri.

Për të kontaktuar me autoren shkruani tek:

Shërbesa Joyce Meyer, Shqipëri
c/o AEP Box 50, KP 119
Tiranë
ose telefononi: 0692055966

Ju lutemi, kur të shkruani, përfshini dëshminë tuaj ose ndihmën që keni marrë prej këtij libri. Kërkesat tuaja të lutjes janë të mirëpritura.

Në SHBA, ju lutem shkruani:

Joyce Meyer Ministries
P.O.Box 655
Fenton, MO 63026
USA
(636) 349- 0303
www.joycemeyer.org

Në Kanada, ju lutem shkruani:

Joyce Meyer Ministries— Canada
Lambeth Box 1300
London, ON N6P 1T5
CANADA
1- 800- 727- 9673

Në Australi, ju lutem shkruani:

Joyce Meyer Ministries— Australia
Locked Bag 77
Mansfield Delivery Centre
Queensland 4122
AUSTRALIA
(07) 3349 1200

Në Angli, ju lutem shkruani:
Joyce Meyer Ministries— England
P.O. Box 1549
Windsor SL4 1GT
UNITED KINGDOM
01753 831102

Në Afrikën e Jugut, ju lutem shkruani:
Joyce Meyer Ministries— South Africa
P.O. Box 5
Cape Town 8000
SOUTH AFRICA
(27) 21- 701- 1056

LIBRA NGA JOYCE MEYER NË SHQIP

Fushëbeteja e Mendjes

Një Mënyrë e Re Jetese

Paqe

Pse, o Zot, Pse?

Revolucioni i Dashurisë

Thuaji Se i Dua